



## DREJTËSI PËR VIKTIMAT KOSOVARE! PETICION DREJTUAR SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË KOMBEVE TË BASHKUARA

*Ne i kërkojmë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të sigurojë kompesim për Romët, Ashkalitë, dhe Ballkan Egjiptianët të ekspozuar ndaj helmimit me plumb në Kosovë, në përputhje me gjetjen e Panelit për të Drejtat Humane të Kombeve të Bashkuara që Kombet e Bashkuara (UN) janë drejtpërdrejt përgjegjëse për çfarë ka ndodhur.*

*Të drejtat e Romëve janë të drejta të njeriut!*

*Ne u bëjmë thirrje atyre që e besojnë këtë dhe duan një drejtësi të barabartë për Romët, të nënshkruajnë këtë peticion.*

Në vitin 1999, Misioni Administrativ i përkohshëm i Kombeve të Bashkuara (UMNIK) mori përsipër administrimin e Kosovës. Misionit i kërkohej legalisht të respektonte të drejtat humane të popullit -- Serb, Shqiptar, dhe Kosovar – nën juridikcionin e tij. Por nuk ndodhi kështu.

Një vendbanim i Romëve në Mitrovicë u shkatërua në fund të vitit dhe UNMIK-u i lëvizi ata në kampet për personat e zhvendosur brenda vendit (IDP) pranë një vendi rezikshmerisht te ndotur, të përdorur për shkrirrjen e plumbit. Oficerët e Kombeve të Bashkuara (UN) ishin në dijeni që zona ishte e rrezikmërisht dhe e ndotur. Ushtarët Francezë me nivele shumë të larta të plumbit në gjak u evakuan nga zona, por romët– përfshirë fëmijët dhe gra shtatzëna u lejuan të qëndronin në kamp. Gjatë dekadës pasardhëse shëndeti i tyre u përkeqësua, situatë kjo e vëzhguar nga UMNIK-u. Gratë nuk mund të mbartnin shtatzaninë, ose e ndërprenin si të mundnin. Ishte si një ferr mbi tokë, dhe UN dinte se çfarë po ndodhte dhe si ta ndalte atë. Ata bëne disa përpjekje periodike jo shumë entuziaste, të cilat nuk patën impakt në përmirësimin e cilësisë së jetës së këtyre njerëzve.

Ekspozimi kundrejt plumbit, në cfarëdo sasi qoftë ai, është i rrezikshëm. Por nivelet e larta të gjetura në gjak dhe në flokë të fëmijëve Romë që jetonin në këto kampe ishin përtëj cdo limiti – Shkencëtarët Evropianë dhe Amerikanë u shprehën se nuk kishin parë asnjëherë një rast të tillë. Këto fëmijë Romë, shumica e tyre tanë të rritur, janë të dënuar të kenë një jetë të shkurtër me probleme shëndetësore mendore dhe fizike, për shkak të mos marrjes së masave të mjaftueshme nga UNMIK-u.

E nevojshme për tu thënë, kjo nuk u ndodhi popullsisë jo-rome që jetonin në të njëjtën zone pasi ato në mënyrë të sigurtë u rivendosen diku tjetër.

Në shkurt të këtij viti viktimat moren disa masa drejtësie. Me ndihmën e përfaqësuesit ligjor të Shteteve të Bashkuara (US), Dianne Post, 138 Romë, Ashkali, and Ballkan Egyptianë, arritën të sigurojne një opinion nga paneli këshillues per të drejtat humane i UNMIK-ut, në favor të tyre.

Opioni 80-faqësh është qortues. Ai kritikon Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për mosbashkëpunim me procesin dhe për fshehjen e qëllimshme të dokumentave kyçë. Opinion i kostaton gjithashtu se është ai mbështetur në steriotipet e tij me natyrë diskriminuese duke akuzuar Romët se ata janë vetë përgjegjës për problemet e tyre shëndetësore për shkak te "stilit të tyre të jetesës".

Opioni dënon UNMIK-un për dhunimin e një sërë të drejtave njerzore: të drejtën për të jetuar; të drejtën për të lindur i lirë nga trajtimi degradues dhe jo-njerëzor; të drejtën e shëndetit; të drejtën për një standart të përshtatshëm jetese; të drejtën për të lindur i lirë nga diskriminimi racor; të drejtën për të lindur i lirë nga diskriminimi gjinor; Të drejtën e fëmijës.....

Pergjigja e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara? Në 22 Prill 2016 ai shprehu keqardhjen e tij dhe tha se do mendojë mbi këtë.

Kjo nuk është mjaftueshëm.

Romët e ekspozuar kundrejt tmerrit të helmimit afatgjatë meritojnë një shfajësim të pakufizuar dhe kompesim për kushtet skëterrë që ata patën gjatë kohës kur ata ishin nën administrimin e UNMIK-ut.

Zoti Sekretar i Përgjithshëm – merre përsipër këtë çështje dhe jepu këtyre Romëve njohjen, shfajesimin, dhe kompesimin, që ata meritojnë. Mënyra se si ju po e trajtoni këtë çështje turpëron Kombet e Bashkuara dhe zhvlerëson angazhimet e organizatës tuaj përkundrejt respektimit të drejtave humane të grave, fëmijëve, dhe minoritetëve etnike.